



Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Prodator Received / Delivered		29.03.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Org / Unit	Hr. Prot Pr. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIDSHCK/1669/2022			1/3	



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.144/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.144/2022 të datës 18.02.2022 të parashtruar nga ankuesja

me adresë banimi Komuna e Gjakovës, kundër organit të punësimit/Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike-administrative "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 29.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, Shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.144/2022 të datës 18.02.2022, të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e emëruar sipas Vendimit me numër 01 Nr.112/02-18586 të datës 12.07.2021 në pozitën Drejtoreshë në shkollën "Mustafa Bakija" në Gjakovë, me datën 18.02.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me kompensimin e mjeteve të shpenzuara për ushqim gjatë ditëve të pranisë në punë si dhe shpërblimin jubilar proporcionalisht me vitet e përvojës së punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 18.02.2022 me numër protokoll 848/2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 07.02.2022 nga përfaqësuesi i ankueses; Kërkesën e ankueses të datës 24.01.2022 e parashtruar në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Komunën e Gjakovës; Vendimin me numër 01Nr.112/02-18586 të datës 12.07.2021 lidhur me emërimin e ankueses në pozitën drejtoreshë; Vërtetimin e datës 29.12.2021

lidhur me përvojën e punës së ankueses; Vërtetimin e datës 10.01.2022 lidhur me përvojën e punës së ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses të datës 25.02.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 15.03.2022 nga Komuna e Gjakovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Konkursin e datës 15.03.2021 nga Komuna e Gjakovës mbi shpalljen e pozitave për drejtor të shkollave në komunën e Gjakovës; Përgjigjen e datës 03.03.2022 nga Komuna e Gjakovës në kërkesën e ankueses për kompensim.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, rezulton se ankuesja është e emëruar sipas Vendimit me numër 01 Nr.112/02-18586 të datës 12.07.2021 në pozitën Drejtoreshë në shkollën "Mustafa Bakija" në Gjakovë. Me datën 24.01.2022 ankuesja ka parashtruar kërkesën për kompensim nga kontrata kolektive e arsimit në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Komunën e Gjakovës. Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Gjakovës me datën 03.03.2022 i ka kthyer përgjigje ankueses duke njoftuar të njëjtën që kontrata kolektive e arsimit është shfuqizuar dhe tashmë nuk është në fuqi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 2 paragrafit 4 ku përcaktohet se: *"Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike."*, ka konstatuar se pozita Drejtoreshë në Shkollën "Mustafa Bakija" në Komunën e Gjakovës të cilën ankuesja e mban sipas Vendimit me numër 01 Nr.112/02-18586 të datës 12.07.2021, hyn në kategorinë e nëpunësve të shërbimit publik dhe rrjedhimisht ankuesja nuk e ka statusin e nëpunësit civil.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.144/2022 të datës 18.02.2022, të parashtruar nga ankuesja

Në kuptim të dispozitave të nenit 24 paragrafit 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nëpunësi i shërbimit publik ka të drejtë të ankohet të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.




Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.144/2022

Ardita Perçuku-Shyti



Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- Drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Komunën e Gjakovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjakovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

